

BREAKING NEWS

x

VRASJA E KLODIAN RASHES, PROKURORIA FINALIZON AKUZEN PER POLICIN QE QEL...

AKTUALITET

Lëviznin nëpër qytet me drogë dhe armë, 2 persona arrestohen në befasi në mes të lokalit

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
27 PRILL 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Policia e Beratit ka finalizuar operacionin e koduar “Osumi”.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në DVP Berat, pasi kanë grumbulluar informacione në rrugë operative në lidhje me 2 shtetas të cilët shpërndanin lëndë narkotike në doza të vogla në zonën e Çorovodës dhe

posedonin armë zjarri si dhe kishin tendencë në fushën e kultivimit të bimëve narkotike, kanë organizuar punën duke e ndjekur me metoda speciale të hetimit.

Si rezultat i operacionit të zhvilluar në qytetin e Çorovodës, në një lokal, autoritetet arrestuan në flagrancë shtetasit:

P.K, 46 vjeç, banues në Çorovodë, të cilit gjatë kontrollit fizik iu gjetën dhe sekuestruan, 11 doza Kokainë, 520 euro, 57.400 lekë dhe 4 aparate celular.

E.H, (i dënuar më parë), 37 vjeç, banues në Çorovodë, të cilit gjatë kontrollit fizik iu gjetën dhe sekuestruan 1 armë zjarri Pistoletë me 6 fishekë dhe 1 dozë Kokainë, si dhe gjatë kontrollit në banesë iu gjetën një sasi farash cannabis sativa, 1 armë gjahu dhe 27 gramë lëndë narkotike Cannabis Sattiva.

Gjithashtu filloi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasin L.S, 44 vjeç, (pronar i lokalit) për veprën penale "Moskallëzim krimi".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", "Mbajtja e armëve dhe municioneve pa leje", "Mbajtja e armëve të gjahut pa leje".

YOU MAY LIKE

by **mgid**

Čaša ujutro sagorijeva 3 - 5
kilograma sedmično